



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5, 15.1 (c) dhe nenit 21.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (të referuar më tej si "Marrëveshja për HPEA") në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjen e përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë edhe ato të konkluduara në emër të saj nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1321/2007, e datës 12 nëntor 2007 që përcakton rregullat implementuese për integrim në bazën qendrore të informatave për ndodhitë në aviacionin civil të shkëmbyera në përputhje me Direktivën 2003/42/EC e Parlamentit dhe Këshillit European, duhet të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 08/2010 PËR  
RREGULLAT IMPLEMENTUESE PËR INTEGRIM NË BAZËN QENDRORE TË  
INFORMATAVE PËR NDODHITË NË AVIACIONIN CIVIL TË SHKËMBYERA  
NË PËRPUTHJE ME DIREKTIVËN 2003/42/EC TË PARLAMENTIT DHE  
KËSHILLIT EUROPIAN**

*Neni 1*

1.1 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1321/2007, datë 12 nëntor 2007, që përcakton rregullat implementuese për integrim në bazën qendrore të informatave për ndodhitë në aviacionin civil të shkëmbyera në përputhje me Direktivën 2003/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit European, e referuar më tej si Rregullorja e Komisionit, me këtë deklorohet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1321/2007 i është bashkangjitur si aneks kësaj Rregulloreje dhe formon pjesën e saj përbërëse.

1.2 Dispozitat e neneve 1 deri 4, të Rregullores së referuar të Komisionit janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

1.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të Rregullores së Komisionit, të përhira në Shtojcën I të Marrëveshjes për HPEA, do të jenë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

#### *Neni 2*

2.1 Përkufizimet e termave "Komuniteti", "Ligji i Komunitetit", "Legjislacioni i Komunitetit", "instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", nëse referohen në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Aneksit II të Marrëveshjes për HPEA.

#### *Neni 3*

Në rast të ndryshimit të verzioneve të përkthyer në gjuhët shqipe dhe apo serbe me verzionin original në gjuhën angleze të Rregullores së Komisionit, (EC) Nr. 1321/2007 verzioni në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian do të ketë përparësi.

#### *Neni 4*

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2010.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtori i përgjithshëm